



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
“Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”**

Universiteti EPOKA

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD Eglja LUCA

Prof. Asoc. Gjergj ISLAMI

Shtator / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në: Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit

1	IAL aplikues:	Universiteti Epoka
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 698, datë 19.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 31, datë 27.01.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 100, datë 01.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	3 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 0 studentë; 2020-2021 0 studentë; 2021-2022 1 Student

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Epoka", është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti "Epoka", zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Universiteti "EPOKA" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.92, date 20.10.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2021.

Universiteti "Epoka", është i organizuar në 3 fakultete, konkretisht:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Master Profesional në "Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit", licensuar me Urdhër Nr. 698, datë 19.10.2018. Programi është akredituar për herë të parë, me VBA Nr. 100, datë 01.11.2019, kohëzgjatja e këtij akreditimi është 3 vite, me afat deri në 30.09.2022.

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit", ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Ky programi është i vetmi program i llojit të vetë në vënd i ofruar nga Universiteti Epoka. Programi është aktiv që prej vitit 2018-2019. Gjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 programi nuk ka patur asnjë student të regjistruar. Gjatë vitit aktual të studimit 2021-2022 programi në fjalë ka vetëm një student të regjistruar. Gjatë takimit në institucion na u tha që fakulteti dhe departamenti kanë kryer një fushatë marketimi shumë aktive për të thithur student për programin në fjalë, por si rezultat i pandemisë, këto takime nuk rezultuan në numër studentësh. Gjithashtu gjatë takimit u informuam që IAL ka vënë në dispozicion edhe bursa për studentët që do të regjistroheshin, por përsëri këto iniciativa nuk u përkthyen në student të regjitruar.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 100, datë 01.11.2019 janë:

1. Institucioni të rishikojë planin mësimor dhe rregulloren e programit të studimit me qëllim rritjen e orëve totale që studenti duhet të realizojë në auditor;
2. Institucioni të strukturojë aktivitetet praktike brenda programit të studimit;
3. Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada e tituj, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi;
4. Institucioni të rishikojë kategorizimin e lëndëve/moduleve sipas veprimitarive formuese, në përputhje me VKM 41/2018, me qëllim ndarjen e praktikës profesionale/intershipit nga puna për temën e diplomës;
5. Institucioni të shtojë marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerë publikë ose privatë në kuadër të realizimit të praktikës profesionale të studentëve të këtij program studimi, programi i praktikës të miratohet nga departamenti e të monitorohet nga personeli akademik, të dokumentohet në trajtë relacioni ose ditari dhe të miratohet nga institucioni/kompania që e ofron atë;
6. Institucioni të shohë mundësinë e rishikimit të përmbajtjes dhe/ose emërimit të programit të studimit në mënyrë që të reflektohet përputhshmëri e plotë mes aktivitetetve formuese të ofruara dhe profilit të specialistit të formuar përmes këtyre aktivitetetve;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Rekomandim 1



Referuar RVB orët në auditor janë rritur në 16 orë në javë (rreth 480 ore për 30 javë mësimi). Referuar planit mësimor [Aneks 14], rezulton se orët që duhet të zhvillojë studenti në auditor janë 512 orë në vit. Referuar RVJ të akreditimit të mëparshëm, orët vjetore në auditor kanë qenë 432. GVJ referuar dokumentacionit në dosjen e vetvlerësimit, dhe vizitës në institucion nga takimi me studentët konstatoi se, ndryshe nga parashikimi i planit mësimor, numri total i orëve të zhvilluara në auditor është rreth 8-10 orë në javë (rreth 240-300 ore për 30 javë mësimi). GVJ konkludon se **ky rekomandim është përmbushur kryesisht.**

Rekomandim 2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



4

Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që rekomandimi është plotësuar në përputhje me qëllimin e përshkruar në rekomandim. GVJ konkludon se **ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Rekomandim 3

Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që numri i stafit në raport me ngarkesën mësimore vazhdon të jetë i ulët, madje sapo ishte larguar edhe një key staf. Stafit është me një ngarkesë përtej optimalet. Referuar RVB të akreditimit të mëparshëm, shtimi i stafit është evidentuar si mjeti për të arritur reduktimin e mbingarkesës së personelit akademik. Aktualisht vërehet se personeli akademik ka të njëjtën ngarkesë akademike si më parë, me një mesatare prej rreth 16 orësh mësimore në javë [Aneksi 21]. GVJ konkludon se **ky rekomandim nuk është përmbushur.**

Rekomandim 4

Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që rekomandimi është plotësuar në përputhje me qëllimin e përshkruar në rekomandim. GVJ konkludon se **ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Rekomandim 5

Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që rekomandimi është plotësuar pjesërisht, kjo edhe për faktin e dy viteve të pandemisë dhe mosnjohjes së këtij programi studimi në tregun vëndas. Gjithsesi, në kushtet kur programi i studimit është aktualisht me 1 student, ky rekomandim nuk përbën prioritet dhe nuk ndikon në cilësinë e programit të studimit. GVJ konkludon se **ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.**

Rekomandim 6

Në RVB thuhet se kurrikulat janë në përditësim të vazhdueshëm. Ndërkohë, emërtimi i programit të studimit vazhdon të jetë i njëjtë. Referuar RVJ të akreditimit të mëparshëm, rekomandimi ka pasur për qëllim, përveç rishikimit të kurrikulës, riemërtimin e programit në MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit”, duke përjashtuar termin “Inxhinieri Ndërtimi”, pasi përmbajtja e programit është më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. GVJ konkludon se **ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.**

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit", të ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit "Epoka", filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UE, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As. Gjergj Islami dhe PhD. Egla Luca. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Vizita në Universitetin "Epoka", u realizua në datën 21/04/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti Epoka është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.08.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 29/36 Prot, datë 01.08.2022. Universiteti Epoka përcjell në ASCAL më datë 1 shtator me anë të shkresës me Nr. 100/3 Prot, datë 29.08.2022 "Komente në lidhje me draft raportin".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- Për komentin e IAL mbi përmbushjen e Rekomandimit 3 nga akreditimi i mëparshëm; Universiteti evidenton përpjekjet e vazhdueshme për përmbushjen e këtij rekomandimi por nuk bie ndesh me vlerësimin e ekspertëve. **Raporti në këtë pikë nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi përmbushjen e Rekomandimit 6 nga akreditimi i mëparshëm; Universiteti evidenton arsyet e vendosjes së emërimit të programit të studimit "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit" dhe paraqet evidencat përkatëse. Në argumentimin e paraqitur vihet re mungesa e dakordësisë së universitetit me Rekomandimin e Bordit të Akreditimit (në lidhje me emërtimin), ndërkohë që nuk janë ndërmarrë hapa për

ndryshimin e emërimit të programit. Gjithashtu, përmbajtja e programit të studimit, edhe pas rishikimit, është më e gjerë se fusha e inxhinierisë së ndërtimit dhe përfshin edhe arkitekturën, planifikimin, fusha të tjera të inxhinierisë, mbrojtjen civile etj. **Raporti në këtë pikë nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.1;**

Universiteti shpreh dakordësi për këtë pikë. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.3;**

Universiteti dakordësohet me rekomandimin, edhe pse komenti është i njëjtë për të dy standardet, ai qëndron. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.4;**

Universiteti shpreh dakordësi për këtë pikë. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.6;**

Universiteti shpreh dakordësi për këtë pikë. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.8;**

Universiteti shpreh dakordësi për këtë pikë. **Raporti pëson plotësim** “GVJ rekomandon që praktikat të kryehen pranë kompanive të dedikuara të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjen ndaj zjarrit. Në pamundësi të kompanive të sipërpërmendura, studentët të kryejnë praktikat pranë departamenteve të menaxhimit të riskut. Këto departamente janë prezente në pjesën më të madhe të kompanive shqiptare.”

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin IV.4;**

Departamenti shprehet se nuk ka kompetencë mbi oraret e bibliotekës. Rekomandimi nuk i adresohet departamentit por institucionit që organizon programin e studimit. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

- Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.2;**

Universiteti, pasi parashtron vështirësitë e kushtëzuara nga situata pandemike, shpreh dakordësi për këtë pikë. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon që programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtar, por është një risi në tregun vëndas. Programi i studimit është konceptuar në përputhje me vizionin e Universitetit Epoka dhe në bashkëpunim me projektin K-force, sipas të cilit programi i studimit luan rol të rëndësishëm në përmirësimin sigurisë së vëndit. Ky program është menduar të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës të cilat përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë evoluar me mjaft shpejtësi, sikurse edhe me ndryshimet më të fundit teknologjike, duke synuar që t’u mundësohet specialistëve të rinj bërja lehtësisht pjesë e tregut të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. <i>Referencë: Annex 2 “Statuti i IAL”</i>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti akademik 2019 – 2020 dhe është në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore të vëndit. Produkti i tij ka identitet të qartë profesional. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore. Objektivi kryesor i programit në fjalë është ritja e sigurisë nëpërmjet menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes nga zjarri. <i>Referencë: Annex 2 “Statuti i IAL”</i>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në mendimin e dekaint lidhur me programin e studimit, ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Masteri Profesional në "Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit" është një program studimi bashkëkohor dhe në përputhje të plotë me qëllimet dhe

	<p>misionin edukativ të Universitetit Epoka, si përsa i takon ofertës akademike dhe kërkimit shkencor, ashtu edhe këndvështrimin ndaj sipërmarrjes, parë këto në funksion të shërbimit ndaj një ekonomie gjithnjë e më të përparuar. GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe syllabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit dhe njësisë bazë. U gjet që ky PS është konkurues në kuadrin kombëtar dhe ka ambicien të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Në këtë perspektivë duket qartë që ky PS zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. PS është në përputhje të plotë me statutin e IAL 2018-2022 dhe gjithashtu në planin strategjik të Universitetit EPOKA.</p> <p><i>Referencë: Annex 1 - Mendimi i Dekanit; Annex 4 - Plani strategjik i Fakultetit të Inxhnierisë së Ndërtimit</i></p>								
<p>Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Referuar kurrikulës së këtij programi studimi dhe studimit të tregut të punës, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor, ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij PS konstatohet, që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai përfshihet. Fusha e menaxhimit të riskut është relativisht e re dhe panjohur, megjithatë kurrikula e programit ofron lëndë të cilat synojnë jo vetëm ruajtjen e sigurisë por edhe zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>Referencë: Annex 16- Study on the labor market before the opening of the program; Annex 14- Curricula of the study program</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.2</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar planit strategjik të Universitetit EPOKA, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, si edhe planin strategjik të njësisë bazë (Plani strategjik i departamentit të inxhnierisë së ndërtimit), GVJ konstaton që PS Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ofrohet në përshtatje dhe në</p>

	zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit. <i>Referencë: Annex 4 - Strategic Plan of CE</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konsultoi paraprakisht statutin e institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Programi është konceptuar në përputhje me frymën e statutit të institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për këtë program studimi. Drejtimet prioritare të IAL janë: të qenit institucion arsimor dhe kerkimor inovativ, ritja e vlerave shoqërore dhe përmirësimi i cilësisë së jetës bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. PS i përmbush më së miri këto të fundit. <i>Referencë: Annex 2- The Statute of HEI</i>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” përkon me Nivelin 7 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofrohet për një kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik, me gjithsej 60 ECTS. Ky program ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, dhe në përfundim studenti pajiset me diplomë universitare “Master i Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Ky program mbështetet në strategjinë institucionale të Universitetit Epoka, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e inxhinierisë së ndërtimit/ menaxhimit të riskut, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe atyre të vetë Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Bazuar në strategjinë institucionale, GVJ konstaton që programi i studimit është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Programi i studimit ka marrë akreditimin e parë periodik bazuar në Vendimin Nr. 100 date 01.11.2019 të Bordit të Akreditimit, e për rrjedhojë emërtimi, struktura dhe programi ndjekin fushat akademike të institucionit. <i>Referencë: Annex 2- The Statute of HEI</i>
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar	Ekonomia jonë po rritet dhe nevoja për inxhinierë ndërtimi/ekspert me njohuri komplekse në fushën e menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes nga zjarri po prevalon me shpejtësi në kërkesat që ka tregu. Veçanërisht spektri i ngushtë i profilizimit të një eksperti të ambientit të ndërtuar me drejtim menaxhim risku dhe mbrojtje nga zjarri,

dhe trendet globale të zhvillimit.	garantojnë suksesin e këtij programi duke patur parasysh që të tilla drejtime parashikohet të marrin një zhvillim edhe më të madh në dekadën e tretë të këtij mijëvjeçari. Bazuar në mendimin e dekanit/përgjegjësit të departamentit dhe në dokumentat e vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ konstaton që programi i studimit zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Referencë: Annex 1 - Mendimi i Dekanit; Annex 4 - Plani strategjik i Fakultetit të Inxhnierisë së Ndërtimit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e riskut, duke njohur konkurrencën në tregun e punës, dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabysset e lëndëve, kostatohet që në këtë PS synohet t’u jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij. Këto objektiva mbështeten në dy shtylla kryesore: <ul style="list-style-type: none"> - Të përgatis student me dije gjithëpërfshirëse në menaxhim risku dhe mbrojtje nga zjarri; - Të kontribuoj në një shoqëri më të sigurt. Këto objektiva karakterizojnë profilin e studimit në përputhje me nivelin e studimeve master; Referencë: Annex 18- Syllabi of the program

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit “Master i Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është ngritur dhe ideuar nga një projekt Erasmus +, KA2 K-Force, studimi i tregut është një nga kërkesat themelore të këtyre lloj projektsh. PS është organizuar në kontakt të ngushtë me partnerët e industrisë dhe nevojat e tyre. Zyra e këshillimit të karrierës mbledh dhe përpunon të dhënat mbi punësimin e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ konstatoi që Institucioni kryen studime për tregun e punës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme të fushës së ndërtimit e rrotull saj. Këto marrëveshje janë një bazë e mirë për punësimin e ardhshëm të të diplomuarve. Universiteti Epoka si një universitet privat duke thelluar dhe materializuar kooperimin me biznesin dhe tregun e punës ofron për të gjitha këto kompani një gamë shërbimesh dhe procesesh që kanë të bëjnë me natyrën e institucionit, detyrat dhe qëllimet që kanë këto biznese. <i>Referencë: Annex 25- Tabular summary data on student's real employment; Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në aspektin formues objektivat e PS “Master i Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” synojnë t’u sigurojnë studentëve dhe të diplomuarve dije profesionale, zotësi në përdorimin e tyre, kuptim dhe zgjidhje të problemeve në ndërtim, dëshirë dhe ambicje për të njohur e përvetësuar informacionin bashkëkohor etj. Realizimin e këtyre objektive GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi për produktin e deritanishëm, si dhe duke analizuar kurrikulën ekzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta, në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentit. <i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të</p>	<p>Falë marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që Institucioni ka me institucione homologe në vënde të huaja si dhe gjenezës së PS nga një program Erasmus+, programi i studimit është në linjë me programe të ngjashme në vënde të tjera të rajonit si Serbia dhe Bosnje Hercegovina.</p>

studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<i>Referencë: Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe direktivat e BE, ndjek dhe zbaton kartën e Bologni-as. Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Epoka <i>Referencë: Annex 4 - Plani strategjik i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit</i>
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Programi i studimit ka në fokus të tij praktikën profesionale. Në dokumentat e vënë në dispozicion nga Institucioni jepen kompanitë specifike ku studentët kanë kryer praktikatat e tyre (4 kompani). Praktika profesionale ka 7.5 ECTS. PS zhvillohet në 2 semestra. Semestri i dytë ka të gjitha lëndët me zgjedhje ku 2 nga të cilat janë lënë praktike në fushën e Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit. Nga biseda me zyrën e këshillimit të karierrës na u tha që për kompani të cilat nuk janë pjesë e listës, IAL nënshkruan paraprakisht marrëveshje bashkëpunimi, përpara se studenti të zhvilloj praktikën. <i>Referencë: Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i>
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	IAL të gjitha programet e studimit i zhvillon në gjuhën angleze, përfshi edhe programin e Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit. Ky program studimi është themeluar nga një program ndërkombëtar, dhe si i tillë vazhdon të zhvillohet në gjuhën angleze. <i>Referencë: RVB</i>
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Gjatë vizitës në IAL, një nga sugjerimet që GJV dha ishte konvertimi i masterit profesional në një seri modulesh të dedikuara për një fenomen të caktuar, si përshëmbull: Mbrojtja nga zjarri dhe menaxhim risku; Mbrojtja nga përmytjet dhe menaxhimi përkatës i riskut; Risk assessment në ndërtim dhe siguria në punë; Menaxhimi i riskut sizmik; etj. Rekomandimi ishte që student të caktuar mund të ndjekin

	<p>një, disa ose të gjithë modulet. Në këtë kontekst programi i studimit do të bëhet më atraktiv dhe do të tërhiqte më shumë student. Duke parë faktin që për 2 vite programi nuk kishte asnjë student të regjistur, dhe këtë vit kishte vetëm 1.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL dhe fakulteti të ndjekin strategji marketingu të ndryshme nga ato të deri tanishmet. Në kuadër të ritjes së nr të studentëve, GVJ sugjeroi gjatë vizitës në IAL që mësimi duhet të zhvillohet në fundjavë dhe jo gjatë mbasditeve të vona (17:00 - 21:00), pasi ky mund të jetë një prej arsyeve së bashku me vëndndodhjen e IAL që i bën studentët potencial të largohen nga ky program mjaft interesant studimi. Referencë: Annex 42-Marketing Policy</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Numri i ulët i anëtarëve të stafit akademik të dedikuar për programin e studimit, por me një përvojë të përshtatshme në disiplinat specifike të programit të studimit, tregon që IAL i ka burimet njëzore por duhet të ris numrin e tyre. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë Arkitekturës. Në strukturën përbërëse të tij përfshihet edhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (përgjegjës për programin e studimit). Bazuar në tabelën 1 dhe tabelën 2</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 Fakulteti i Inxhinierisë Arkitekturës ka gjithsej 53 personel akademik, nga ku 37 janë personel akademik Efektiv (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof.Dr; - 3 Prof.As; - 16 Dr/PhD; - 5 Doktorë në proces;

	<ul style="list-style-type: none"> - 11 Msc; <p>Personeli Akademik me Kontratë (PAK) në rang fakulteti (16 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Prof As; - 3 Dr/PhD; - 9 Msc; <p>Po për këtë vit akademik, Personeli Akademik në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit, përbëhet nga 9 pedagogë gjithsej, të gjithë personel efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr; - 2 Prof.Asoc.; - 3 Dr; - 2 Doktorë në proces; - 1Msc; <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas (evidencës 75 Tabela Përmbledhëse_Shqip.pdf, tabela nr.6.1 dh 7), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 3 pedagogë gjithsej, të gjithë pedagogë efektiv (PAE), nga ku 1 Prof.As. dhe 2 Dr.</p> <p>Për vitet e mëparshme, ku programi i studimit nuk ka patur student, IAL nuk ka dhënë informacion lidhur me stafin e angazhuar.</p> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni të marrë masa për shtimin e stafit akademik dhe uljen e ngarkesës për stafin ekzistues. Rekomandim edhe nga akreditimi mëparshem.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 75 Tabela Përmbledhëse_Shqip, tabela nr.6.1 dh 7</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, si edhe të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. PS përveç karakterit specifik që ka, është pjesë integrale e fushës së departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe gjithashtu Fakultetit përkatës. <i>Referencë:</i></p>

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<i>Annex 34- Data on the scientific research of the academic staff</i>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ iu referua gjetjes në RVB ku shkruhet se programi i studimit Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, i cili, sipas ligjit të arsimit të lartë, është njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor dhe Master. Departamenti mirëpret studentët që dëshirojnë të studiojnë për programet e studimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe me procesin Evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Në planin strategjik të këtij departamenti GVJ gjeti objektivat dhe synimet e departamentit lidhur me zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 22- Tabular data on the number of programs 1st, 2nd, 3rd cycle of studies offered by the responsible unit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master profesional është brenda profilit të institucionit dhe cilësia e tij garantohet nga vetë Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit që shihet të jetë me përvojë dhe arritje të dukshme në punën e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të

realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti EPOKA ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit, duke siguruar një bashkëpunim funksional. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. Bashkëpunimi nuk është vetëm në nivel fakulteti por edhe në nivel universiteti me të gjitha hallkat mbështetëse.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit të studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit institucioni, nxiti bashkëpunimin midis personelit brenda Universitetit EPOKA nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyre të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. <i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations;</i></p>

	<i>Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga takimet në Institucioni me përgjegjësin e departamentit dhe përfaqësuesin e zyrës së karrierës u tha që nëse studenti nuk është në gjëndje të gjej kompani për kryerjen e praktikës, atëherë departamenti e adreson në një nga kompanitë që ka marrëveshje bashkëpunimi. IAL është pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare si SUCESS i cili ka në fokus bashkëpunimin akademi-sektor privat. Gjithashtu Universiteti EPOKA është pjesë e Tirana Inc, inicativë që nxit inovacionin dhe bashkëpunimin.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Universiteti EPOKA ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi të cilat shfrytëzohen vec të tjerash edhe për kryerjen e praktikave profesionale. <i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i>			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar në DVV dhe në bisedat e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se Universiteti Epoka organizon trajnime profesionale për studentët, kryesisht në formën e leksioneve të hapura. <i>Referencë: Dosja e vetëvlerësimit; Annex 45 - Example of Documents on Training Events</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB-së, në mënyrë periodike departamenti harton raporte mbi mbarëvajtjen e marrëveshjeve dhe funksionimin e tyre në kuadër të realizimit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL


Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit, është i strukturuar në 1 vit akademik dhe 2 semestra të rregullt. Zhvillohen gjithsej 6 lëndë dhe 1 praktikë profesionale dhe 1 punim diplome.</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit, është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), sipas VKM 41 24.01.2018. Gjithashtu, paralel me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), institucioni përdor edhe kreditet amerikane, dhe sistemin e vlerësimit GPA amerikan. Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishpërndarjen e krediteve pasi jo të gjitha lëndët kanë të njëjtën rëndësi në programin e studimit, e për rrjedhojë duhet të kenë numër të ndryshëm kreditesh dhe orësh.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program</i></p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit përkon me kategorinë 7 të kornizës së kualifikimeve. Ky program studimi është mjaft i fokusuar dhe i detajuar dhe krijon specialist në fushën e menaxhimit të riskut. <i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 4 - Strategic Plan of CE</i></p>

<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit përkon me kategorinë 7 të kornizës së kualifikimeve. Ky program studimi është mjaft i fokusuar dhe i detajuar dhe krijon specialist në fushën e menaxhimit të riskut të cilët fitojnë njohuri të përparuar në fushën përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit i zhvillon njohuri dhe kompetenca sipas nivelit të kornizës së kualifikimeve. <i>Megjithatë sugjerohet konvertimi i masterit profesional në një seri modulesh të dedikuara për një fenomen të caktuar, si përshembull:</i></p> <p>Mbrojtja nga zjarri dhe menaxhim risku; Mbrotja nga përmbytjet dhe menaxhimi përkatës i riskut; Risk assessment në ndërtim dhe siguria në punë; Menaxhimi i riskut sizmik;</p> <p>Sugjerohet që student të caktuar mund të ndjekin një, disa ose të gjithë modulet. Në këtë kontekst programi i studimit do të bëhet më atraktiv dhe do të tërhiqte më shumë student. Duke parë faktin që për 2 vite programi nuk kishte asnjë student të regjistruar, dhe këtë vit kishte vetëm 1 student.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL dhe fakulteti të ndjekin strategji të ndryshme marketimi nga ato të deri tanishmet.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 42-Marketing Policy</i></p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë. Programi ofrohet me 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vjecare. Gjuha e mësimdhënies është anglisht</p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program</i></p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A - E me peshën specifike të përcaktuar sipas VKM 41 24.01.2018 konkretisht:</p> <p>A - Lëndë Bazë/(15%-20%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>B- Lëndë Karakterizuese të Programit (50%-55%)/ 35% / 21 ECTS</p> <p>C -LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE (12%-15%) / 25% / 15 ECTS</p>

	<p>D- LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>E - DETYRIME PËRMBYLLËSE (3%-5%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>Vihet re që vetëm një kategori përmbush detyrimin e krediteve dhe është kategoria D. Të gjitha kategoritë e tjera janë më pak ose më shumë në përqindje se rekomandimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishpërndarjen e lëndëve në tipe veprimtarie, shtimin e lëndëve të reja dhe rishikimin e krediteve të secilës lëndë varësisht peshës dhe kategorisë së lëndës.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program</i></p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programi i studimit ka të parashikuar ngarkesën në kredite të praktikës profesionale (7.5 ECTS) në ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane</p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2</p> <p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i Studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ofrohet nga Universiteti Epoka në Tiranë, dhe është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Nr. 698, datë 19.10.2018 si program i ciklit të dytë, me kohë të plotë, 1 vit akademik, dhe përbëhet nga 60 ECTS. Njësia bazë përgjegjëse i përmbush të gjitha detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti i Inxhnierisë së Ndërtimit është pjesë e Fakultetit të rkiteturës dhe Inxhnierisë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Institucioni, rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë,</p>

	<p>përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>										
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka në përbërje tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës; 2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; 3. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Prof. As.” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “PhD”. Koordinator i programit të studimit është profesor E.L, i cili është përgjegjës i departamentit.</p> <p><i>Referencë: Annex 29- Decision of the appointment of the study program coordinator; Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program</i></p>										
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në vitin akademik 2021 -2022, ka në përbërje të tij 53 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 37 janë staf akademik efektiv (PAE), nga ku 21 me grada / tituj, dhe 16 staf akademik me kontratë, (PAK), nga ku 7 me grada / tituj.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p>										
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për vitin akademik 2019 – 2020:</p> <table border="1" data-bbox="657 1608 1257 1908"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2 Prof. As</td> <td>1 Prof.As</td> </tr> <tr> <td>3 Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>7 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2020 – 2021:</p>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	2 Prof. As	1 Prof.As	3 Dr.	-	2 Msc	1 Msc	7 PAE	2 PAK
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>										
2 Prof. As	1 Prof.As										
3 Dr.	-										
2 Msc	1 Msc										
7 PAE	2 PAK										



	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>
	2 Prof. As	1 Prof.As
	3 Dr.	-
	3 Msc	1 Msc
	8 PAE	2 PAK
Për vitin akademik 2021 – 2022:		
	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>
	1 Prof. Dr	-
	2 Prof.As	
	3 Dr.	-
	3 Msc	-
	9 PAE	0 PAK
	<p>Për sa më sipër Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, si dhe përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Referencë: Annex 75- Tabela Përmbledhëse _shqip, tabelat; 1 dhe 2;</i></p>	
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	<p>Universiteti Epoka vë në dispozicion personel ndihmës për mbështetjen e zhvillimit të laboratoreve. Si për shëmbull në lëndën Durability of Concrete shfrytëzohet laboratorit i materialeve i cili mirëmbahet nga laboranti përkatës, po ashtu edhe laboratorit i kompjuterave. Lidhur me praktikatat profesionale ato ndiqen nga Koordinatorit i programit të studimit. <i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program; Referencë: Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program</i></p>	
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit, Koordinatorit i programit të studimit është përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Referencë: Annex 29- Decision of the appointment of the study program coordinator; Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program</i></p>	

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.				
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i programit dhe drejtuesi i departamentit janë i njëjti person. Gjithsesi IAL ka një sistem shumë të mirë dokumentimi dhe informimi. <i>Referencë: Annex 29- Decision of the appointment of the study program coordinator; Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Inxhnierisë së Ndërtimit, përgjegjës për PS zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. Departamenti dhe cdo anëtar i personelit akademik/administrative ka akses të plotë tek dokumentat e sipërpërmendura. <i>Referencë: Annex 4 - Strategic Plan of CE; Annex 22- Tabular data on the number of programs 1st, 2nd, 3rd cycle of studies offered by the responsible unit; Annex 2- The Statute of HEI; Annex 3- Institution Development Strategy</i>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në	Programi “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ofrohet me 60 ECTS në 1 (një) vit akademik, me 8 lëndë me 7.5 ECTS secila. Lëndët janë të ndara në module sipas dispozitave ligjore

<p>përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>në fuqi. Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A-E me peshën specifike të përcaktuar në VKM 41 24.01.2018 konkretisht:</p> <p>A - Lëndë Bazë/(15%-20%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>B- Lëndë Karakterizuese të Programit (50%-55%)/ 35% / 21 ECTS</p> <p>C -LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE (12%-15%) / 25% / 15 ECTS</p> <p>D- LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>E - DETYRIME PËRMBYLLËSE (3%-5%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>Vihet re që vetëm një kategori përmbush detyrimin e krediteve dhe është kategoria D. Të gjitha kategoritë e tjera janë më pak ose më shumë në përqindje se rekomandimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishpërndarjen e lëndëve në tipe veprimtarie, shtimin e lëndëve të reja dhe rishikimin e krediteve të secilës lëndë varësisht peshës dhe kategorisë së lëndës. Bazuar në tabelën 9.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program; Tabela 9 (Tabela përmbledhëse)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>PS “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ofrohet me 60 ECTS në një vit akademik, me 30 ECTS në semester, me 8 lëndë me 7.5 ECTS secila. Lëndët janë të ndara në module sipas dispozitave ligjore në fuqi. Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A-E me peshën specifike të përcaktuar në VKM 41 24.01.2018.</p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program; Tabela 9 (Tabela përmbledhëse)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mënyra e vlerësimit është e përcaktuar edhe në sylabus. <i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program</i></p>


<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Zyra e pranimit të studentëve ju jep të interesuarve të gjithë informacionet e nevojshme lidhur me regjistrim, transferim apo ekuivalentim. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit EPOKA</p> <p><i>Referencë: Annex 9.1-Smart_Student_Guide_2019-2020; Annex 9.2- Registrar's Office. Procedures on Students Records;</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo leksionet, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënësve të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Duke qënë se programi i studimit nuk ka qënë aktiv për dy vite akademike, nuk ka raportime për ndryshime eventuale në fillim të vitit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe</p>

<p>parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në praktikë studentët/studenti kryejnë pakë orë fizike në auditor. Ka qënë pjesë e rekomandimeve të akreditimit të mëparshëm ritja e orëve në auditor dhe ky rekomandim nuk është përmbushur pasi orët në auditor janë reduktuar.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e numrit të orëve në auditor ose kalimi në mësim në fundjavë në mënyrë që të zhvillohen orët e plota javore të parashikuara. Nga biseda me studentin GVJ u informua që mesatarisht kryhen 10 orë fizike në javë.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program. Tabela 13 (Tabela përmbledhëse)</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Tregu vëndas është relativisht i limituar për punësimin e studentëve që mbarojnë këtë program studimi, andaj, <i>vlen sugjerimi i dhënë më sipër për të ndryshuar formation e masterit, konvertimi në module, të cilat vetëm nëse i mbaron të gjithë modulet studenti pajiset me diplomë master profesional.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Lëndët dhe shpërndarja e tyre brënda vitit mundësojnë arritjen e objektivave formues të PS. Lidhur me aftësimin profesional, <i>GVJ rekomandon që programi i studimit të nxis kryerjen e praktikave pranë institucioneve që zhvillojnë menaxhim risku në përditshmërinë e tyre.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program; Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table eith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program; Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations;</i></p>



	<i>Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>PS “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, ofrohet me 60 ECTS në 1 (një) vit akademik, me 8 lëndë me 7.5 ECTS secila. Lëndët janë të ndara në module sipas dispozitave ligjore në fuqi. Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A-E me peshën specifike të përcakuar në VKM 41 24.01.2018.</p> <p>A - Lëndë Bazë/(15%-20%) / 12.5% /7.5 ECTS</p> <p>B- Lëndë Karakterizuese të Programit (50%-55%)/ 35% / 21 ECTS</p> <p>C -LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE (12%-15%) / 25% / 15 ECTS</p> <p>D- LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>E - DETYRIME PËRMBYLLËSE (3%-5%) / 12.5% / 7.5 ECTS</p> <p>Vihet re që vetëm një kategori përmbush detyrimin e krediteve dhe është kategoria D. Të gjitha kategoritë e tjera janë më pak ose më shumë në përqindje se rekomandimi.</p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program; Tabela 9 (Tabela përmbledhëse)</i></p>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Departamenti përpiqet dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në bibliotekën e institucionit, por edhe duke pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura e përdorur në sylabuse është bashkëkohore. Programi i lëndëve dhe moduleve është përditësuar pjesërisht duke u bazuar në rekomandimet e akreditimit të fundit.</p> <p><i>Referencë: Annex 36- List of books; Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 48- Policy on Continuous Improvement of Study Program;</i></p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të	<p>Përmbajtja e programit të studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke tentuar të krijojë bazat e</p>

<p>synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave.</p> <p><i>Lidhur me aftësimin profesional <u>GVJ rekomandon</u> që programi i studimit të nxis kryerjen e praktikave pranë institucioneve që zhvillojnë menaxhim risku në përditshmërinë e tyre.</i></p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program; Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët/studenti një bazë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>Referencë: Annex 18- Syllabi of the program; Annex 14- Curricula of the study program; Raporti i vlerësimit të brendshëm; Annex 28- List of Institutional Corporations; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët e industrisë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programin e studimit të lëndëve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut.</p> <p><i>Referencë: Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit që mbulon masterin profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit ka një personel që mundëson zhvillimin cilësor të këtij programi.</p> <p>Referuar dokumentave dhe vizitës në institucion rezulton se stafi i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike ka qenë i njëjtë, pasi për dy vite akademike programi nuk ka patur studentë konkretisht:</p> <table border="1" data-bbox="667 633 1267 875"> <thead> <tr> <th data-bbox="675 645 962 696"><u>PAE:</u></th> <th data-bbox="970 645 1259 696"><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="675 707 962 759">1 Prof. Asoc.</td> <td data-bbox="970 707 1259 759">-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="675 770 962 822">2 Dr./PhD</td> <td data-bbox="970 770 1259 822">-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="675 833 962 884">3 PAE</td> <td data-bbox="970 833 1259 884">0 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Gjithashtu në kuadër të projektit kanë marë edhe trajnime ekstra për fushën specifike të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit.</p> <p><i>Referencë: Annex 19- CV of the academic staff; Annex 20- Tabular data for academic staff in the Main Unit and Responsible Basic Unit;</i></p>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Asoc.	-	2 Dr./PhD	-	3 PAE	0 PAK
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>								
1 Prof. Asoc.	-								
2 Dr./PhD	-								
3 PAE	0 PAK								
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë. Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik rezulton se 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik.</p> <p><i>Referencë: Annex 19- CV of the academic staff; Annex 20- Tabular data for academic staff in the Main Unit and Responsible Basic Unit;</i></p>								
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e</p>								

<p>personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.</p> <p><i>Referencë: Annex 19- CV of the academic staff; Annex 20- Tabular data for academic staff in the Main Unit and Responsible Basic Unit; Annex 21- Tabular data eith full teaching load of academic staff in all study programs.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Mbikëqyrja e praktikave kryhet nga koordinatori i programit të studimit. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet Zyrës së Karrierës, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të dytë të studimeve në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me ndërmarrjet / punëdhënësit</p> <p><i>Referencë: Annex 29- Decision of the appointment of the study program coordinator; Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program; Annex 28- List of Institutional Cooperations</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiti Epoka vë në dispozicion personel ndihmës për mbështetjen e zhvillimit të laboratorëve. Si për shëmbull në lëndën Durability of Concrete shfrytëzohet laborator i materialeve i cili mirëmbahet nga laboranti përkatës, po ashtu edhe laborator i kompjuterave.</p> <p><i>Referencë: Annex 14- Curricula of the study program; Referencë: Annex 29.1- Duties of the coordinator of study program</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>IAL nëpërmjet zyrës së karrierës dhe Alumni kryen anketa dhe pyetësorë lidhur me cilësinë e programit të studimit në mënyrë që ti përshtaten sa më mirë tregut të punës.</p> <p><i>Referencë: Annex 31.2- Alumni satisfaction survey; Annex 31.1- Student satisfaction survey</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Zyra e dekanit të studentëve është një instancë mjaft aktive në institucion, dhe si e tillë është pjesë integrale e përmirësimit të programeve të studimit dhe vecanërisht të programit “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit</p> <p><i>Referencë: Annex 31.2- Alumni satisfaction survey; Annex 31.1- Student satisfaction survey; Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe studentëve është e interesuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe të punësuar në funksion të tërheqjes prej tyre të ideve dhe propozimeve të ndryshme për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Referencë: Annex 31.2- Alumni satisfaction survey; Annex 31.1- Student satisfaction survey; Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Institucioni është gjithmonë e gatshme të përshtas programet e studimit sipas nevojave madhore kombëtare.</p> <p><i>Referencë: Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ mbështetur në “Annex 3- Institution Development Strategy”, të Universitetit EPOKA” si dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se në strategjinë e institucionit, janë përcaktuar si qëllime prioritare përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni zhvillon trajnime të vazhdueshme për të përmbushur këtë qëllim. <i>Referencë: Annex 31.1- Student satisfaction survey; Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstaton se institucioni aplikon forma të diversifikuara të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike, të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga përgjegjësi i departamentit, i cili harton raport në mënyrë periodike mbi cilësinë dhe metodat e mësimdhënies.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në dokumentacionin në sistemin e informacionit të ASCAL, në informacionin e siguruar nga takimi me studentin e programit, rezulton se institucioni i përfshin studentët në forma të ndryshme në vlerësimin periodik, nëpërmjet plotësimit të anketës çdo semestër/pedagog si dhe nëpërmjet informacionit që studentët paraqesin për problematika të ndryshme tek Dekani i studentëve. Nga takimi me studentin dhe NJBSC na u tha që numri minimal i pyetësorëve për tu marrë në konsideratë është 5. Kjo do të thotë që këtë semestër vlerësimi nga studenti nuk mund të meret për bazë.

	<i>Referencë: Annex 26 - Internal Quality Assurance System;</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë në Universitetin Epoka, për programin e studimit, rezultojnë të jenë procese periodike, rezultatet e të cilave publikohen si pjesë e raporteve vjetore, në ëëbin e institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	IAL falë projekteve të shumta ndërkombëtare që është pjesë, ka mundëi që në mënyrë konstante të tregoj praktikat më të mira në mësimdhënie dhe të nxis dhe inkurajoj personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <i>Referencë: Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, labororet, praktikat mësimore e profesionale, etj. Ndarja e tyre në program është si më poshtë: (<i>Annex 14 - Curriculum of the study program</i>) Leksione 128 / 128 orë; Seminar 128 / 128 orë; Laboratore 0/0 orë në audior; Kontroll i vazhduar i dijeve 0; Vizita 120/120; Te tjera 374/374; Në total janë 750 / 750 orë; <i>Sipas tabelës 13 (Tabela 13 (Tabela përmbledhëse))</i> Leksione 16;



	<p>Seminare 16;</p> <p>Ushtrime / Laboratore 0 orë në auditor;</p> <p>Kontroll i vazhduar i dijeve 0;</p> <p>Praktikë profesionale 0;</p> <p>Projekti i diplomimit 0;</p> <p>Në total janë 16 orë në auditor;</p> <p>Nga totali i orëve shihet që mesatarisht për 30 javët e vitit akademik, studenti duhet të jetë në auditor rreth 11.6 orë në javë. Nga takimi me studentin rezultoi që nr i orëve në auditor është rreth 8 orë në javë.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon ritjen e orëve në auditor për programin e studimit.</u></i></p> <p><i>Referencë: Tabela 13 (Tabela përmbledhëse); Annex 14 - Curriculum of the study program</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Mësimdhënia në Universitetin Epoka rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herëpashere.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Pjesë tjetër e mbështetjes së IAL është edhe nxitja financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe publikime të ndryshme, të cilat ndikojnë drejt për së drejti me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>



<p>nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p><i>Referencë: Annex 19- CV of the academic staff; Annex 20- Tabular data for academic staff in the Main Unit and Responsible Basic Unit;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Stafit ka ekspertizën e duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e ngarkesës tek stafi akademik. Të gjithë profesorët japin lëndë të cialt janë ngushtësisht të lidhura me fushat e tyre të ekspertizës.</p> <p><i>Referencë: Annex 19- CV of the academic staff; Annex 20- Tabular data for academic staff in the Main Unit and Responsible Basic Unit;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet mënyrave të ndryshme (të shpjeguara në RVB) Institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj instancat administrative të Universitetit Epoka kryejn verifikimet përkatëse dhe propozon masat përkatëse, të cilat konsistojnë në ndryshimin e rregulloreve apo të zëvendësimit të pedagogut, i cili nuk e ka kompetencën e duhur profesionale dhe didaktike.</p> <p><i>Referencë: Annex 31.2- Alumni satisfaction survey; Annex 31.1- Student satisfaction survey; Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 26 - Internal Quality Assurance System; Annex 46 - Quality Policy</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me studentin konstatoi se metodat e mësimdhënies janë të larmishme, duke u përpjekur të përfshijnë studentët sa më shumë në diskutime dhe zgjidhje të situatave konkrete,</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre.</p> <p><i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit;</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimdhënies dhe ai shkencor kryhen në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen sic duhet. Institucioni ka pasur ambiente cilësore që nga fillimi i tij. Një ekip me teknikë është i punësuar, që të përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambjenteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, etj. Kampusi i IAL është një nga më të mirët në vend. <i>Referencë: Annex 33- Infrastructure on the functioning of the study program</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Infrastruktura dhe mjediset e Universitetit Epoka plotësojnë kërkesat për zhvillimin normal të procesit mësimor për programin e studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të kompletuara mirë me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet, etj.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Disa nga sistemet informatike që përdoren masivisht në Universitetin Epoka janë EIS (epoka interaction system) dhe LMS. Stafii akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. I gjithë procesi i ruajtjes dhe së dokumentacionit është i dixhitalizuar. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me pajisjet e përshtatshme dhe mjetet e nevojshme në përputhje me qëllimet e programit. Zyra e IT është përgjegjëse për asistencë teknike në laboratorët. Kampusi ka akses me valë në të gjitha ndërtesat dhe tre laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me programe të dedikuara

	kompjuterike. <i>Referencë: Annex 33- Infrastructure on the functioning of the study program</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në RVB dhe viziten në instiucion, Institucioni vë në dispozicion një numër të përshtatshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 36- List of books</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm të librave, të revistave dhe publikimeve të tjera shkencore në shërbim dhe në përshtatje me programin e studimeve. Orari i përshtatet me orarin e programeve të studimit. Universiteti "EPOKA" operon në mjedise të mjaftueshme si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të kohës. Biblioteka ofron një fond të konsideruar librash dhe literature në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Literatura, përbëhet nga tekste, mësimore dhe literaturë ndihmëse me një numër të konsiderueshëm librash dhe revistash akademike/shkencore për realizimin e programit të studimit të MP në MR & MZIN; ajo është në gjuhë të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe personelit akademik. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 36- List of books</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka e Universitetit Epoka, pasurohet çdo vit me tituj të rinj. Universiteti "EPOKA" ka akses edhe në disa biblioteka online ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra dhe punime shkencore. Në fond të saj EPOKA ka mbi 2000 revista shkencore dhe cdo antëtar i stafit mund të navigoj në JSTORE nëpërmjet kredencialeve të universitetit EPOKA. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 36- List of books</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në dispozicion të programit të studimit janë tre laboratorëve të pajisur me kompjuter për zhvillimin e praktikave mësimore. Në të gjitha ambientet e Universitetit Epoka ka akses Interneti. Studentët mund të shfrytëzojnë edhe kompjuterat e bibliotekës. Vec tyre IAL ka laborator cilësor testimi materialesh ndërtimi. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 36- List of books</i>


<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik përdor rregullisht e-learning. Në funksion të mësimdhënies personeli akademik përdor platformën Moodle LMS dhe google dirve dhe google classrom. Platformat më të përdorura në IAL janë:</p> <p>EIS</p> <p>LMS</p> <p>TURNITIN</p> <p>Google Services</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nëpërmjet Moodle LMS personeli akademik dhe studentët shkëmbejnë informacione dhe materiale të ndryshme. Studenti ka arritshmëri në materialet e depozituara nga pedagogu, ku përfshihen leksione, ushtrime, etj.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Temat e diplomave zhvillohen në kuadër të lëndës “Supervised Independent studies. Kjo lëndë drejtohet nga pedagog të ndryshëm të cilët ndjekin ecurinë e studentëve gjatë procesit të diplomimit.</p> <p><i>Annex 14 - Curriculum of the study program</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin plotësues të vënë në dispozicion, Universiteti EPOKA ofron monitorim horizontal lidhur me cilësinë e mësimdhënies. Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë është krijuar komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë si një strukturë autonome dhe përhershme. Së bashku me zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, bordin e provimeve dhe bordi i vlerësimit të performancës akademike dhe përmirësimit të cilësisë, institucioni kontrollon dhe jep rekomandimet e veta mbi cilësinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e</p>

	<p>vazhdueshëm të saj. Ky komision vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime, të cilat i gjykon të arsyeshme. Komisioni bashkëpunon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore dhe bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. NJSBC harton raporte dhe i dorëzon këto të fundit në rektorat. <i>Referencë: Annex 26 - Internal Quality Assurance System;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe nga takimet në IAL, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, përgjegjës për programin e studimit është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Njësia bazë organizon takime orientuese me studentët potencial dhe gjithashtu takime me organizatat shtetërore dhe private që mund të ofrojnë student për programin e studimit. <i>Referencë: Annex 26 - Internal Quality Assurance System;</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, përgjegjës për programin e studimit, si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe komisioni për sigurimin e cilësisë, struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metodatat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika laboratorike, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fusha e ndërtimit, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Shpërndarja e lëndëve bëhet në bazë të përvojës dhe eksperiencës së stafit. Për programin specifik të studimit, stafi akademik ka marrë trajnime në insitucionet partnere të projektit. Kjo ka ndodhur në mënyrë që stafi i përfshirë në program të marrë eksperiencën e duhur për Mbrojtjen nga Zjarri dhe menaxhim risku në Ndërtim. Projekti në vetëvete kishte pjesë edhe mobilitetin dhe rritjen e kapaciteteve të stafit akademik. Ky informacion na u dha gjatë vizitës në IAL dhe takimit me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin.</p>



<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Si rezultat i faktit që Universiteti EPOKA është pjesë e një numri të madh projektesh ndërkombëtare, bën që stafi të përballet në mënyrë të vazhdueshme me leksione, prezantime dhe trajnime të ndryshme nga staf i huaj lidhur me metodat e mësimdhënies. Qoftë kjo në mënyrë direkte, por edhe në mënyrë indirekte, stafi përmirëson qasjen kundrejt mësimdhënies dhe studentëve. Institucioni organizon në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trainimi, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit dhe përfshijnë trajnime në kuadër të shkëmbimeve KA1 dhe nëpërmjet lektorëve të ftuar në Universitetin EPOKA.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në planin strategjik të Universitetit Epoka, si dhe në planin strategjik të programit të studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, personeli akademik dhe personeli ndihmës (koordinatore dhe sekretari), janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Stafi akademik dhe administrativ trajnohen vazhdimisht për implementimin e metodave inovative të mësimdhënies. Bazuar në DVV, Personeli akademik është i lirë të implementojë metoda e forma inovative të mësimdhënies, t’i analizojë ato, të reflektojë anët pozitive dhe negative, duke kryer edhe ndryshimet përkatëse në silabuset e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies e nxënies. Një trajnim i ofruar ishte mbi arsimin dixhital që u ndoq nga stafi akademik.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve janë angazhuar herë pas here lektorë dhe kërkues shkencorë për të shkëmbyer ide dhe metoda. Angazhimi i lektorëve të ftuar të cilët janë profesionist të fushës shihet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies në lidhje me tregune punës. Kjo bazuar në RVB</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. Udhëzuesi i studentëve është dokumenti përmbledhës për të gjithë procesin e studimit në Universitetin Epoka <i>Referencë: Annex 9.1-Smart_Student_Guide_2019-2020; Annex 9.2- Registrar's Office. Procedures on Students Records;</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo silabus, përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. Syllabusi i plotë shpallet në Sistemin Interaktiv Epoka. <i>Referencë: Annex 9.1-Smart_Student_Guide_2019-2020; Annex 9.2- Registrar's Office. Procedures on Students Records;</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke iu referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton, se për të gjitha lëndët vlerësimi është gjithësemestral dhe përfshin forma të ndryshme vlerësimi, si projekte, pjesëmarrje, kuize, mid term, provim final etj. GVJ është e mendimit se këto forma të ndryshme vlerësimi, nxisin angazhimin e studentit, dhe janë në përputhje me diversitetin e studentëve dhe të nivelit të tyre të angazhimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. Ekzistojnë dy periudha për vlerësimin e studeteve. <i>Referencë: Annex 9.1-Smart_Student_Guide_2019-2020; Annex 9.2- Registrar's Office. Procedures on Students Records;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sisteme elektronike të testimit janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë. Me kalimin e kësaj periudhe testimi i studentëve kryhet me metoda klasike. Për studentin e programit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, të gjitha provimet janë kryer fizikisht në klasë.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive kryhet nga pedagogu i lëndës ose në raste të vecanta nga komisioni i dedikuar bazuar kjo në DVV. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e detyrueshme të asistentit në vlerësimin përfundimtar pasi kjo do të riste shkallën e kontrollit në vlerësimet finale.</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet sekretimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga pedagogë të caktuar. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi deri sa dorëzohen në sekretari. Bazuar në udhëzuesin për provime
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se tezat e provimit, përveç vlerësimit me pikë për seksionet e ndryshme, ata i shoqërojnë ato me komente rreth saktësisë së përgjigjeve, orientuese për riprovimet, por edhe për të pasur një proces objektiv dhe të argumentuar vlerësimi.

<p>Kriteri 6. Njësiti përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të tij, dënon reptësisht kopjen dhe plagjiaturën. Gjatë zhvillimit të provimeve salla monitorohet nga dy apo më shumë pedagogë të caktuar e të miratuar nga drejtuesi i departamentit. Bazuar në RVB, përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor programin Turnitin si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për punimet e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e perfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata informohen për vlerësimin nëpërmjet sistemit EIS, mbasi ata kanë plotësuar anketën për vlerësimin e pedagogut. Studentët informohen në syllabusin e lëndës, në rregulloren e provimeve si dhe nga guida e studentit. Të tre këto dokumenta janë të publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit.</p> <p><i>Annex 18- Syllabi of the program: Annex 7.1-Regulation on second cycle study programs.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit ngrihet një komision vlerësimi i përbërë nga pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” i ofron</p>

të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit nuk ofron lëndë specifike lidhur me teknologjinë e informacionit, shkencave humane sociale apo komunikimin. Bazuar në sylabuset e paraqitura nga IAL, disa nga këto komponent përfshihen në lëndë të tjera si përshëmbull lënda “Modelim i llogaritjes së evakuimit” dhe “analiza e rrezikut në procesin e vendimmarrjes” <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike, që realizohet në fund të lëndës. Në nivel institucional Universiteti EPOKA e rregullon këtë proces nëpërmjet direktivës “Për funksionimin e Bordit të provimeve” ku cdo fakultet cakton një ekspert për të vlerësuar cilësinë e provimeve <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 54- Exam Assessment Form; Annex 53- Examination Period Assessment Form; Annex 52- Directive “On the Functioning of the Exam Board”</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që kanë studentët.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon ëorkshope, si dhe zhvillon aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik nxitet nga departamenti të prezantojë punët e tyre apo eksperiencat e tyre në projekte specifike. Këto të fundit prezantohen në trajtën e leksioneve të hapura ku të gjithë janë të ftuar të marrin pjesë. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit;</i>

<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, te cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studenti i programit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ka në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdor atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, si dhe në praktikat profesionale.</p> <p><i>Referencë: Annex 33- Infrastructure on the functioning of the study program</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në programin e studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” aktualisht është vetëm 1 (një) student i regjistruar. Megjithatë, gjatë takimit në IAL na u tha që një pjesë të lëndëve teorike i zhvillon me studentët e masterit shkencor në mënyrë që të nxitet pikërisht puna në grup.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Kjo gjë reflektohet në sylabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se IAL inkurajon zhvillimin e ideve inovative të stafit dhe studentëve, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht. Një shëmbull konkret ka qënë konferenca “4th International balkans conference on challenges of civil engineering” e organizuar nga departamenti i inxhinierisë së ndërtimit. <i>Referencë: Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 27- Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve. Universiteti Epoka shkëmben përvojën e tij me këta universitete duke mundësuar rritjen e mobiliteteve të studentëve/stafit. Si rezultat i pandemisë dhe i kohës së shkurtër që programi i studimit ekziston, mobilitetet e studentëve akoma nuk janë aktive, por nga takimi që patëm me zyrën e projekteve na u tha që programi i studimit duke qënë se është krijuar falë një</p>


	<p>projekti Eramsu +, mobilitetet i ka patur pjesë integrale të implementimit të tij.</p> <p><i>Referencë:Annex 31.2- Alumni satisfaction survey; Annex 31.1- Student satisfaction survey; Annex 3- Institution Development Strategy; Raporti i Vete Vlerësimit; Annex 27-Summary table ëith cooperating institutions for the study program and professional practice</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Infrastruktura dhe mjediset e Universitetit Epoka plotësojnë kërkesat për zhvillimin normal të procesit mësimor për programin e studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”. Laboratori i inxhinierisë së ndërtimit është i pajisur me mjetet e nevojshme për kryerjen e orëve laboratorike. Po ashtu laboratorët janë të pajisur me kompjuterë dhe softuerë të nevojshëm për zhvillimin e gjithë procesit mësimor. Përvec sa më sipër IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione që suportojnë zhvillimin e praktikave.</p> <p><i>Referencë:Annex 33- Infrastucture on the functioning of the study program</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Nga vizita në IAL, GVJ u informua që studenti i vetëm i programit të studimit e kryen praktikën profesionale nën mbikqyrjen e shefit të departamentit pranë një kompanie ndërtimi. <u>GVJ rekomandon që praktikat të kryehen pranë kompanive të dedikuara të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjen ndaj zjarrit. Në pamundësi të kompanive të sipërpërmendura, studentët të kryejnë praktikat pranë departamenteve të menaxhimit të riskut. Këto departamente janë prezente në pjesën më të madhe të kompanive shqiptare.</u>”</p>

Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është e detyrueshme dhe vlerësohet me kredite. Për më tepër kërkohet një vlerësim narrativ mbi performancën e studentit gjatë praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Të gjitha informacionet lidhur me diplomimin janë publike në faqen e internetit dhe gjithashtu në lëndën e diplomës “Supervised Independent Studies”.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Informacioni dhe udhëzimet mbi përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Të gjitha procedurat që ndiqen janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin udhëheqësin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore shkencore, në kuadër të lëndës “Supervised Independent Studies”. Aktualisht studenti sapo e kish filluar ndjekjen e lëndës, duke qënë se është lëndë që zhvillohet në semestrin e dytë. <i>Referencë: Annex 9.1-Smart_Student_Guide_2019-2020; Annex 9.2-Registrar's Office. Procedures on Students Records;</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve	Në rastin e studentëve të programit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e

akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ndërtimit”, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit/raportit të mikro tezës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me studentin, GVJ u informua që personeli akademi e orienton studentin në përcaktimin e temës së diplomës
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti EPOKA vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e testeve apo analizave të ndryshme. <i>Referencë: Annex 33- Infrastructure on the functioning of the study program</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës është garantori i cilësisë së punimit, është ai/ajo që vendosin nëse studenti është gati të prezantoj apo jo.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar RVB-se, nota e lëndës “Supervised Independent Studies” konsiderohet si nota e diplomës. <i>Referencë: Raporti i Vete Vlerësimit;</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>Referencë: Annex 15- Diploma Model; Annex 15.1- Diploma supplement;</i>
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, nga Zyra e Regjistrimit, studentit i vihen në dispozicion suplementi i diplomës. Në suplement pasqyrohen të dhëna të detajuara mbi programin e studimit të zhvilluar.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash të plotë për të gjithë procesin mësimor në vite. Dokumentacioni ruhet për një periudhë pa afat. Të dhënat statistikore përpunohen periodikisht sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për



	arsimin, agjencisë së sigurimit të cilësisës, apo të vetë institucionit. Ky informacion na u dha gjatë vizitës në IAL			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit	Universiteti Epoka, zbaton procedura ligjore transparente për rekrutimin e personelit akademik. Në zyrën e Burimeve Njerëzore [Vizita e GVJ], gjenden të dhëna të detajuara për secilin anëtar të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ. Informacioni dhe të dhënat janë të plota për të gjithë personelin akademik respektivisht me lëndët dhe semestrat në të cilat është i angazhuar stafi i programit të studimit. Informacioni mbi personelin akademik dokumentohet sipas formularit të paraqitur në Aneks 35, të RVB dhe kontrata tip e depozituar në dosje përputhet me atë të paraqitur në Aneksin 44 të RVB. Informacioni mbi personelin akademik ruhet edhe në mënyrë elektronike përmes sistemit EIS.

<p>akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe që ndiqen në mënyrë rigoroze nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. IAL ka miratuar dhe zbaton një rregullore për rekrutimin e stafit, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushte që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH. [Aneks 11]; [Aneks 2].</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Shic përshkruhet më sipër, procedurat e rekrutimit të personelit akademik bazohen në Rregulloren e Rekrutimit të Personelit Akademik e cila zbatohet në nivel institucioni [Aneks 11]. Universiteti publikon informacionin mbi rekrutimet online në faqen ëeb https://epoka.edu.al/mat/regulations/Regulation_Staff_Recruitment.pdf</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me</p>	<p>Shpallja e vendeve vakante kryhet në përputhje me Rregulloren e Rekrutimit të Personelit Akademik [Aneks 11], e cila përcakton hapat e procesit, nga konstatimi i vendeve vakte deri në firmosjen e kontratës. Nevojat identifikohen nga njësia përkatëse dhe më pas, përmes zyrës së burimeve njerëzore ndiqet procedura e rekrutimit. Aplikimet e kandidatëve realizohen online. Vlerësimi kryhet nga një komision i përbërë nga tre anëtarë [Aneks 11/Neni 10].</p> <p>Kriteret e përgjithshme për kandidatët janë të përcaktuara në të njëjtën rregullore [Aneks 11/Neni 11] dhe synojnë përzgjedhjen e personelit akademik të kualifikuar, duke i dhënë peshë të veçantë eksperiencës akademike dhe punës kërkimore të kryer nga kandidati.</p> <p>Publikimi i shpalljeve bëhet online në http://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html</p>

natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për vlerësimin e personelit akademik, Universiteti Epoka zbaton procedura transparente. Vlerësimi kryhet nga studentët por edhe nga vetë drejtuesi i departamentit. Informacioni i hollësishëm mbi vlerësimin e personelit akademik jepet në kreun VI të këtij raporti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga vizita në institucion u konstatua se kushtet dhe mjedisi i punës në tërësi janë mjaft të mira dhe motivuese. U vu re fryma harmonike në marrëdhënie, si në personelin akademik ashtu edhe tek studentët, atmosfera e bashkëpunimit dhe respektit reciprok, pa barriera apo qasje diskriminuese. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, salla interneti, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, Sekretaria mësimore, etj. janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Ekziston një frymë konkurrence pozitive brenda stafit e nxitur nga politikat institucionale për kualifikime të vazhdueshme. Nga takimet me personelin akademik u vu re se kualifikimi dhe shkëmbimi i eksperiencave kryejnë kryesisht përmes programeve Erasmus + apo projekteve në të cilat është i përfshirë universiteti. Gjithashtu, në Aneksin 45.1 të RVB paraqiten një seri aktivitete / trajnimesh në nivel institucional.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit	Përtej shkëmbimeve apo aktiviteteve të përmendura në kriterin 2 të këtij standardi, nuk u konstatuan programe specifike që lidhen me përditësimin e metodave të mësimdhënies apo për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik. Gjithsesi, duhet theksuar se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, personeli akademik në

akademik e të personelit mësimor-shkencor.	nivel universiteti ka adaptuar mjete dhe teknologji të reja komunikimi për t'u përshtatur me situatën [Aneksi 45.1].			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga njohja me dokumentacionin e RVB rezulton se institucioni ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara për realizimin e programit të studimit dhe për përmbushjen e objektivave formuese të tij. Gjithsesi, mbetet sfida rritja e numrit të studentëve, e cila kërkon angazhim të mëtejshëm të personelit në komunikim me kandidatët potencialë dhe institucionet që mund të promovojnë formimin që ofron ky program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Universiteti "EPOKA" ndodhet në rrugën Tiranë-Rinas, në kilometrin 12. Kampusi shtrihet në një sipërfaqe totale 67 000 m ² . Universiteti Epoka, ofron një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e të gjithë aktiviteteve të nevojshme siç janë mjediset e brendshme e të jashtme të një niveli dhe cilësie shumë të lartë dhe kushte jo vetëm për mësim por edhe për punë të pavarur të studentëve. Ambientet e vizituara nga GVJ, si klasa, auditorë, laboratorë kompjuterik, laboratorë të testimeve të materialeve e strukturave të ndërtimit me sipërfaqe 280m ² , salla studimi, zyrat te stafit akademik e administrativ, biblioteka si dhe hapësirat e tjera të përbashkëta si mensa etj. Programi MP në "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit" realizohet në godinën e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje-ftohje dhe me video-projektorë. Lidhja mes kapaciteteve të infrastrukturës dhe numrit të studentëve nuk është tregues domethënës në këtë rast, për sa kohë programi ka vetëm 1 student aktiv.

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita e GVJ dhe Aneksi 33 i RVB rezulton se:</p> <p>Universiteti Epoka ka infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Laboratorët mësimore janë të pajisur me pajisjet e përshtatshme dhe mjetet e nevojshme në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me kompjuter, video-projektor, dhe tabela interaktive. Në të gjitha ambientet e Universitetit Epoka ka akses Interneti.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Përtej konstatimeve të kriterit 2 të këtij standardi, institucioni ka edhe një strukturë për teknologjinë e informacionit që menaxhon pajisjet teknologjike dhe shërbimet elektronike të ofruara nga universiteti. Zyra e IT menaxhon shërbimet e mësimdhënies, sistemin e bibliotekës, shërbimet e Google, sistemin e kurrikulës, sistemin smart card, sistemin EIS për studentët, etj. [Aneks 37]. Më tej këto sisteme trajtohen në standardin IV.5.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka 4 laboratorë për teknologjinë e informacionit me një kapacitet total prej 128 PC [Aneks 37]. Universiteti ofron programet bazë të Microsoft dhe aksesin në Office 365. Gjithashtu rreth 30 videoprojektorë janë të instaluar në klasat e universitetit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Në terma infrastrukture universiteti ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor. Nuk janë paraqitur të dhëna për bashkëpunimet e lidhura në funksion të programit të studimit, që në çdo rast do të ishin të vlefshme për një numër minimal studentësh për të cilët duhen garantuar praktikat profesionale. <i>Sfida mbetet rritja e numrit të studentëve që mund të përfitojnë nga ky program studimi, dhe rrjedhimisht nga kapacitetet e ofruara të infrastrukturës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se biblioteka ofron një fond të konsiderueshëm librash dhe literature në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Në bibliotekë kanë akses të vazhdueshëm personeli akademik dhe studentët.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Fondi i bibliotekës ka rreth 25,000 njësi ku përfshihen libra, tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, revista akademike/shkencore etj. Një listë e hollësishme e literaturës për realizimin e programit të studimit të MP në MR & MZIN paraqitet në Aneksin 36 të RVB, ajo është në gjuhë të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe personelit akademik.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e Universitetit Epoka, pasurohet çdo vit me tituj të rinj. Universiteti "EPOKA" ka akses edhe në disa biblioteka online ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra dhe punime shkencore. [http://ëëë//jstor.org/.]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e pajisur me një sistem katalogimi i aksesueshëm përmes pajisjeve kompjuterike. Sistemi i katalogimit bazohet në sitimin e Library of Congress dhe është mjaft efikas për bibliotekat universitare. Gjithashtu, pasja e një sistemi biblioteke me fond të hapur ku studenti ka akses direkt në fondin e librave vlerësohet mjaft pozitiv dhe nxitës për përdorimin nga studentët, gjë që u konstatua edhe nga GVJ, i cili vuri re shfrytëzim aktiv të hapësirave të bibliotekës.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të	Pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm i cili bazohet në blerje, donacione dhe akses

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

web site www.ascal.alE-mail: info@ascal.al

55

detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	të bibliotekave online. Lidhur me programin e studimit nuk u konstatua një zhvillim specifik për fondin, pasi kërkesat realizohen kryesisht për fusha të përgjithshme (p.sh. inxhinieri ndërtimi, arkitekturë, etj.).								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka funksionon nga dita E Hënë- E Premte: Ora 08:30 - 12:30 dhe Ora 13:30 - 17:30 dhe E Shtunë, ora 09:00 - 13:00. <i>Duke konsideruar që mësimdhënia për programin e studimit MP ë "MR&MZIN" zhvillohet në orët e pasdites, do të ishte e vlefshme që orari i bibliotekës të zgjatej përtej orës 17.30.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti ofron sistemin EIS (Education Information System) përmes të cilit aksesohen të dhënat akademike, financiare dhe ato individuale. Çdo student ka llogari individuale dhe akseson online sistemin duke marrë shërbim të vazhdueshëm dhe të përditësuar në kohë reale [Aneks 37].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	EIS funksionon jo vetëm për studentët por edhe për personelin akademik dhe atë administrativ, të cilët kanë akses në përputhje me pozicionin e tyre në hedhjen, përditësimin apo leximin e të dhënave. Universiteti ka edhe dy udhëzues, për personelin akademik dhe studentët, për përdorimin e sistemit EIS. [Aneks 37.1 dhe Aneks 37.2].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe	Përmes sitemit EIS, studentët mund të regjistrohen në kurse, në provime, të shohin ecurinë e tyre akademike dhe të aksesojnë materiale didaktike. Gjithashtu përmes sistemit mund të aksesohet kurrikula, orari javor dhe njoftimet.

studentët e programit të studimit.	Personeli akademik plotëson syllabuset, frekuentimin dhe notat përmes të njëjtit sistem.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Universiteti ofron sistemin EIS përmes të cilit aksesohen të dhënat akademike, financiare dhe ato individuale. Çdo student ka llogari individuale dhe akseson online sistemin duke marrë shërbim të vazhdueshëm dhe të përditësuar në kohë reale [Aneks 37]. EIS funksionon jo vetëm për studentët por edhe për personelin akademik dhe atë administrativ, të cilët kanë akses në përputhje me pozicionin e tyre në hedhjen, përditësimin apo leximin e të dhënave. Përmes sitemit EIS, studentët mund të regjistrohen në kurse, në provime, të shohin ecurinë e tyre akademike dhe të aksesojnë materiale didaktike. Gjithashtu përmes sistemit mund të aksesohet kurrikula, orari javor dhe njoftimet. Personeli akademik plotëson syllabuset, frekuentimin dhe notat përmes të njëjtit sistem.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi EIS ka role të ndryshme dhe mundëson akses edhe nga drejtuesit duke përfshirë të dhëna të përgjithshme ose duke mundësuar përgatitjen e statistikave dhe analizave bazuar mbi të dhënat e disponuara [Aneks 37].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacioni i detajuar mbi programin e studimit paraqitet edhe në hapësirën eeb të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit ce.epoka.edu.al . Informacioni është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht dhe pasqyron aktivitetin e departamentit dhe programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Aspekti financiar i universitetit mbikëqyret nga Bordi i Administrimit i cili aprovon kostot dhe mbështetjen financiare të nevojshme. Buxheti i universitetit planifikon të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat të nevojshme për mbarëvajtjen e institucionit. GVJ nuk ka në dispozicion të dhëna të hollësishme që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit. <i>Gjithsesi, nisur nga numri i ulët i studentëve (1 në 3 vite akademike) rezulton se ky program nuk garanton stabilitet financiar dhe kostot e tij mbulohe nga të ardhurat e programeve të tjera të studimit që ofron universiteti [Aneksi 40].</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore dhe shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Buxheti i universitetit planifikon të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat të nevojshme për mbarëvajtjen e institucionit. GVJ nuk ka në dispozicion të dhëna të hollësishme që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit. Gjithsesi, nisur nga numri i ulët i studentëve (1 në 3 vite akademike) rezulton se ky program nuk garanton stabilitet financiar dhe kostot e tij mbulohe nga të ardhurat e programeve të tjera të studimit që ofron universiteti [Aneksi 40].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar RVB, Universiteti Epoka është subjekt i një auditimit vjetor të jashtëm për situatën financiare të tij. Raporti përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi të ardhura- shpenzimet e shoqërisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha të dhënat kontabël lidhur me të ardhurat (grantet, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron direkt ose indirekt.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të</p>	<p>Referuar RVB, Universiteti Epoka është subjekt i një auditimi vjetor të jashtëm për situatën financiare të tij. GVJ nuk disponon dokumentacion ku planifikohen ndërhyrje financiare për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>



financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>Universiteti Epoka dëshmon qëndrueshmëri financiare në vitet e fundit, duke pasur zhvillim të vazhdueshëm si në terma infrastrukture ashtu edhe në nivelin dhe impaktin akademik.</p> <p>https://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020_(Albanian).pdf</p> <p>Megjithëse programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit ka rrezikuar të mbyllet në tre vitet e fundit, garancia financiare për të vjen nga performanca e përgjithshme e institucionit e cila paraqitet pozitive.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UE ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikën dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Universiteti Epoka rezulton të ketë dokumentacion të plotë mbi mbulimin e aktivitetit studentor ku përfshihen pranimet, studimet dhe diplomimi i tyre, në

	përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë në Shqipëri. [Aneksi 2-11]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, nga vizita në universitetet dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoi se fryma institucionale dhe e dokumenteve bazë parashikojnë barazinë dhe garantojnë mungesën e diskriminimit për studentët. [Aneksi 2, Aneksi 5]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Faqja e pranimeve në webin e universitetit është e mirë organizuar dhe e pasur me informacion të hollësishëm për studentët që duan të ndjekin studimet apo t'i transferojnë ato. https://admissions.epoka.edu.al/ Këto informacione ofrohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe janë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Në përputhje me udhëzimet e MAS, universiteti publikon informacionin dhe kriteret për pranimet, të cilat janë publike në faqen zyrtare në ëeb. Këto kriteret synojnë të nxisin interesin e studentëve cilësorë duke ofruar edhe bursa për studentët e ekselencës. Kriteret e pranimit në Master Profesional: 1. Studentët që mbajnë një diplomë Bachelor ose ekuivalente në fushat e përcaktuara nga këshilli shkencor i departamenteve përkatëse. 2. Certifikata e Anglishtes Niveli B1 sipas CEFR në një nga provimet e mëposhtme: a. Cambridge b. IELTS c. TOEFL Internet-based Test (iBT) d. TOEFL Paper-based Test (ITP) e. TOEIC f. GESE g. APTIS (4 komponentë)

	https://admissions.epoka.edu.al/home-professional-master-1928-1931.html?lang=EN&dpid=2&t=professional-master&catid=1928&menuid=1931			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<p>Përmes zyrës së pranimeve dhe njoftimeve në ëeb (shih kriteri 4) universiteti informon dhe asiston të gjithë të interesuarit për procesin e pranimeve, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm.</p> <p>Në këtë drejtim, në tre vitet e fundit, interesi i studentëve ka qenë i ulët dhe institucioni e ka kryer informimin vetëm formalisht përmes mjeteve të komunikimit elektronike. Si rrjedhojë e interesit të ulët rezulton që programi i studimit ka qenë joaktiv për dy vite dhe në vitin akademik 2021-2022 ka të regjistruar vetëm 1 student.</p> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> Institucionin të rishikojë politikën e pranimit dhe informimit të studentëve potencialë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloret e institucionit parashikohen kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentit. Konkretisht, Rregullorja e progameve të ciklit të dytë [Aneksi 7.1], Rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë [Aneksi 6] dhe në Rregulloren bazë të universitetit [Aneksi 5], parashikohen të gjithë elementët e nevojshëm për ecurinë e studentit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Informimi i studentëve kryhet përmes zyrës së pranimeve ku bëhet edhe vlerësimi paraprak i statusit të tyre. Përmes kësaj zyre studentët njihen mbi mundësinë për të njehësuar apo transferuar kualifikimet e mëparshme si dhe për kushtet plotësuese (nëse ka) për ndjekjen e studimeve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Rregullorja e progameve të ciklit të dytë [Aneksi 7.1], Rregullore e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë [Aneksi

<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>6] dhe në Rregulloren bazë të universitetit [Aneksi 5], parashikohen të gjithë elementët e nevojshëm për ecurinë e studentit. Rregulloret e institucionit mund të aksesohen në departament dhe bëhen të ditura përmes komunikimit me personelin akademik dhe këshilltarët akademik. Gjithashtu, informimi kryhet edhe përmes sistemit EIS dhe syllabuseve të aksesueshme edhe online.</p> <p>https://eis.epoka.edu.al/curricula/65/program</p> <p>Një udhëzues i posaçëm është hartuar për studentët (Smart Student Guide), ku aspektet e mësipërme dhe procedurat e diplomimit paraqiten të zgjeruara [Aneksi 9.1].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e progameve të ciklit të dytë [Aneksi 7.1], Rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë [Aneksi 6] dhe në Rregulloren bazë të universitetit [Aneksi 5], parashikohen procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit. Rregulloret e institucionit dhe informacioni i detajuar mund të aksesohen në departament, përmes komunikimit me personelin akademik dhe këshilltarët akademik, përmes sistemit EIS dhe udhëzuesit të studentit.</p> <p>https://eis.epoka.edu.al/curricula/65/program</p> <p>[Aneksi 9.1]</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Zyra e pranimeve kryen komunikimin e vazhdueshëm me studentët potencialë të cilët informohen dhe udhëzohen në përputhje me procedurat e miratuara dhe publikuara nga universiteti. Komunikimi realizohet në ambientet e universitetit ose përmes mjeteve elektronike të komunikimit.</p> <p>Një udhëzues i posaçëm është hartuar për studentët (Smart Student Guide), ku jepen informacione të nevojshme për studentët [Aneksi 9.1].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentin e vetëm aktiv të programit të studimit, rezulton se ai ishte i informuar mbi strukturën e plotë të programit. Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë dhe komunikimit me Zyrën e Pranimeve. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës të orientimit kryesisht nga përgjegjësi i Departamentit, i cili është dhe koordinatori i programit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përmes platformës EIS si edhe në ëeb janë të shpallura struktura e programit dhe syllabuset përkatëse. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit (EIS) studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, rregjistrimet, orarin dhe notat</p> <p>https://eis.epoka.edu.al/curricula/65/program</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e këtij programi deri tani rezultojnë 100% të punësuar në disiplina që lidhen kryesisht me shkencat inxhinierike. Profili i ofruar nga programi i studimit, megjithëse një figurë e domosdoshme profesionale, nuk ka ende një pozicion të qartë në tregun e punës. <i>Për këtë arsye, mund të themi që ky kriter evidenton një nga pikat e dobëta të tregut të punës, rrjedhimisht edhe të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentin e vetëm aktiv të programit të studimit, rezulton se ai ishte i informuar mbi organizimin e procesit mësimor dhe logjistikën e infrastrukturën. <i>U vu re një mospërputhje mes orëve në auditor të planifikuara në planin mësimor dhe orëve të realizuara nga studenti (8-10 orë / javë). Gjithashtu u vu re edhe një paqartësi në realizimin e praktikës profesionale, e cila nuk ishte e fokusuar drejtpërdrejt në objektivat e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Sistemi EIS është i aksesueshëm online dhe mundëson një gamë të gjerë të informacionit për studentin. Përmes sitimit EIS, studentët mund të regjistrohen në kurse, në provime, të shohin ecurinë e tyre akademike dhe të aksesojnë materiale didaktike. Gjithashtu përmes sistemit mund të aksesohet kurrikula, orari javor dhe njoftimet. Çdo student ka llogari individuale dhe akseson online sistemin duke marrë shërbim të vazhdueshëm dhe të përditësuar në kohë reale [Aneks 37].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Ky program studimi nuk ka patur studentë të regjistruar në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020 – 2021. Në vitin akademik 2021 – 2022 është regjistruar 1 student .
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në të dhënat e përmendura në kriterin 1 të këtij standardi përfshihet i gjithë informacioni që lidhet me regjistrimet, çregjistrimet dhe performanca e detajuar për secilin student. Në aspektin statistikor nuk u konstatuan raporte specifike për programin e studimit, por të dhëna kumulative paraqiten në raportin vjetor të institucionit. https://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020_(Albanian).pdf
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Nga vizita në zyrën e regjistrimit (sekretaria mësimore), GVJ konstatoi se ekzistojnë të dhëna të plota për studentët e diplomuar dhe studentin aktual të programit të studimit. Këtu përfshihen gjithë informacionet që lidhen me regjistrimet, çregjistrimet dhe performanca e detajuar për secilin student.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht	Zyra e regjistrimeve ka databazën e plotë të të dhënave mbi studentët, e cila është e aksesueshme edhe në mënyrë elektronike në kohë reale përmes sistemit EIS. GVJ mundi të ketë në kohë reale të dhënat e kërkuara në këtë zyrë. Sistemi


të verifikueshme nga personat e autorizuar.	mundëson llogaritjen automatike të mesatares së ponderuar të studentëve dhe gjenerimin e transkriptove automatike.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Referuar takimeve të GVJ, informacionit online dhe RVB rezulton se zyra e karrierës dhe alumni mban kontakte me të diplomuarit duke hartuar një databazë me ecurinë e tyre dhe duke gjeneruar të dhëna mbi përthithjen e tyre nga tregu i punës. Të diplomuarit kontaktohen individualisht përmes kontakteve të disponueshme apo rrjeteve sociale e profesionale. Ata plotësojnë pyetësorë ku kërkohet informacion mbi punësimin dhe karrierën e tyre. https://cpao.epoka.edu.al/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Universiteti Epoka ka të ngritur Këshillin Studentor, i cili funksionon i pavarur dhe me përfaqësi të studentëve të universitetit. Këshilli ngrihet përmes zgjedhjeve dhe kryetari dhe një prej nënkryetarëve përfaqësojnë studentët në Senatin Akademik. Dy nënkryetarët e tjerë bëjnë pjesë përkatësisht në Këshillin e Etikës dhe në Komisionin për Sigurimin e Cilësisë. Dy anëtarë të këshillit janë pjesë e Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët. Për shkak të numrit të ulët të studentëve, programi i studimit nuk ka përfaqësues direkt në këto struktura.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin	Sipas statutit studentët janë pjesë e vendimarrjes në Senatin Akademik, Bordin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi gjithashtu se Këshilli Studentor funksionon dhe antarët e tij përçojnë shqetësimet e studentëve në të gjitha trupat vendimmarrëse.

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë; është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe adresimin më të mirë të nevojave të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në lidhje me programin e studimit MP Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit vihet re një lehtësim i ngarkesës mësimore në raport me parashikimet në planin mësimor [takimi i GVJ me studentin].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke qenë se feedback në këtë program studimi është i kufizuar, për shkak të numrit të ulët të studentëve (1 në 3 vite) ky kriter rezulton i papërputhshëm me problematikat aktuale të programit.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Megjithëse formalisht procesi i vlerësimit të mësimdhënies nga studentët rezulton të jetë kryer, nuk mund të vlerësojmë impaktin e këtij procesi në programin specifik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka të ngritura zyrën e regjistrimit dhe zyrën e karrierës dhe alumni të cilat mundësojnë informacion të plotë mbi ecurinë akademike dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës. Këto zyra asistojnë studentin gjatë studimeve si dhe mbajnë lidhje me të edhe pas diplomimit. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, siç janë Zyra e Regjistrimit, Koordinatori i programit, Zyra e Pranimeve, Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Rregulloret e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që ata të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Në ndihmë të studentëve vijnë edhe guidat studentore dhe sistemi EIS [Aneksi 9.1].
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e karrierës dhe alumni mundëson këshillimin e studentëve për tregun e punës dhe praktikën profesionale. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit. <i>Për këtë program studimi, për shkak të kushteve të tregut të punës, mundësitë e punësimit në pozicione plotësisht të përputhshme me kompetencat që ofron programi rezultojnë të jenë minimale.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e	Referuar takimeve të GVJ, informacionit online dhe RVB rezulton se zyra e karrierës dhe alumni mban kontakte me të diplomuarit duke hartuar një databazë me ecurinë e tyre dhe duke gjeneruar të dhëna mbi përthithjen e tyre nga tregu i

punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	punës. Të diplomuarit kontaktohen individualisht përmes kontakteve të disponueshme apo rrjeteve sociale e profesionale. Ata plotësojnë pyetësorë ku kërkohet informacion mbi punësimin dhe karrierën e tyre. https://cpao.epoka.edu.al/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në Universitetin Epoka, është institucionalizuar si një strukturë organizative e përhershme emërtuar “Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë” (KPSC) nën Senatin Akademik [Aneksi 8 dhe Aneksi 9], i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ofruar nga Universiteti "EPOKA" në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë (NJSBC), Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Bordin e Provimeve [Aneksi 10]. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë të Institucionit, është zgjedhur nga Senati Akademik. Ky komision zbaton Politikën e Cilësisë, Direktivën për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Sigurimin e Cilësisë dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë [Aneksi 11.1, Aneksi 13, Aneksi 46 dhe Aneksi 49]. Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë përfaqësues të secilës njësi kryesore, duke

	<p>përfshirë edhe kryetarin. Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës shqyrton të gjitha propozimet për lëndë të reja dhe ndryshime në lëndët ekzistuese të kurrikulës të programit të studimit dhe siguron mbështetje dhe këshilla për departamentet përkatëse për zhvillimin e kurrikulave [Aneksi 43]. Bordi i Provimeve përbëhet nga një kryetar dhe të paktën një përfaqësues nga secili fakultet. Bordi i provimeve siguron cilësinë e provimeve në përputhje me Direktivën për Provimet [Aneksi 50 dhe Aneksi 52].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga 10 anëtarë [Aneksi 26] dhe zbaton Politikën e Cilësisë së institucionit [Aneksi 46]. Në përbërje të tij janë një përfaqësues i studentëve, një përfaqësues i alumni dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p>https://aeqi.epoka.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Universiteti Epoka, përdor instrumente matëse dhe vlerësuese për metodologjitë vlerësuese që aplikon, siç janë: vlerësimet e studentëve, vlerësimet e kolegëve, forma individuale të vlerësimit të performancës së stafit akademik si dhe vlerësimin e raporteve vjetore mbi mësimdhënien, të nxëniet dhe standardet përkatëse të cilësisë. Universiteti kryen vlerësimin duke përdorur instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta me student të diplomuar, ish studentë, staf akademik dhe administrativ. Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani janë të informuar në detaje në lidhje me rezultatet e procesit dhe kanë mundësi të ndërhyjnë për të bërë përmirësime kur është e nevojshme. Raporti vjetor institucional miratohet nga Senati dhe bëhet publik për të gjithë të interesuarit.</p> <p>https://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020_(Albanian).pdf</p> <p>Me mbarimin e vitit akademik, kryhet vlerësimi i stafit akademik nëpërmjet vlerësimit të studentëve në bazë të çdo kursi, vlerësimi i performancës individuale nga fakulteti si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien nga departamenti në fund të çdo viti akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek</p>	<p>Universiteti Epoka përdor të gjitha instrumentet për forcuar Sigurimin e Cilësisë, si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin</p>


<p>procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Cilësisë të Institucionit, Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës, Bordi i Provimeve, Komisioni i Etikës etj, ku palët e interesuara si përfaqësuesit e studentëve, stafit akademik, dhe administrative janë pjesë e vlerësimit dhe mbikëqyrjes. Universiteti Epoka në bazë të politikës së tij të përgjithshme për të siguruar cilësinë e programit të studimit, në përputhje me standardet e kërkuara nga legjislacioni shqiptar ka Statutin [Aneksi 2], Planin Strategjik [Aneksi 3], Politikat e Cilësisë [Aneksi 46] dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë [Aneksi 49].</p> <p>Mekanizmat formal për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, janë rishikimi i planit mësimor para fillimit të çdo semestri dhe rishikimi periodik, të cilat miratohen nga Senati me vendimmarrje kolegjiale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përgjegjës për programet e ciklit të dytë të studimeve është Departamenti, i cili administron dhe zhvillon programet e studimit. Ndryshimet kurrikulare kalojnë nga Departamenti, në Fakultet e më pas në Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës prej ku dërgohen në Senat. Për ndryshimet në program përdoren formate standarde dhe dokumenti Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit [Aneksi 43 dhe Aneksi 48].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Procesi i rishikimit të programit të studimit dhe ndërhyrjet për përmirësimin e kurrikulës aplikohen në përputhje me përshkrimin në kriterin 1 të këtij standardi.</p> <p><i>Gjatë vizitës GVJ konstatoi se për programin e studimit janë në proces ndryshimet lidhur me rekomandimet e akreditimit të fundit.</i></p>



<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti monitoron cilësinë e programeve të studimit dhe aplikon analiza në disa nivele. Vlerësimi semestral nga studentët mbi cilësinë e mësimdhënies është një instrument që krijon feedback të vazhdueshëm mbi programin e studimit. Në këtë rast, ky instrument humbet vlerën e tij për shkak të numrit të studentëve. Analiza vjetore e institucionit përmbillet me raportin vjetor ku vlerësohen në tërësi treguesit e cilësisë të programeve të studimit. Kjo analizë nuk ka impakt të drejtpërdrejtë në programin e vlerësuar në këtë raport.</p> <p><i>Megjithëse instrumentet ekzistojnë, problematika kryesore lidhet me numrin e studentëve, si kusht i domosdoshëm për ekzistencën e programit dhe më tej për vlerësimin e mbarëvajtjen e tij.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve analizohen sipas kompetencave në Departament, në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin Cilësisë si dhe në Rektorat. <i>Për programin në fjalë, njësoj si në kriterin 3 të këtij standardi, impakti i këtij procesi zhvlerësohet nga numri i studentëve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Universiteti monitoron cilësinë e programeve të studimit dhe aplikon analiza në disa nivele. Vlerësimi semestral nga studentët mbi cilësinë e mësimdhënies është një instrument që krijon feedback të vazhdueshëm mbi programin e studimit. Në këtë rast, ky instrument humbet vlerën e tij për shkak të numrit të studentëve.</p> <p><i>Megjithëse instrumentet ekzistojnë, problematika kryesore lidhet me numrin e studentëve, si kusht i domosdoshëm për ekzistencën e programit dhe më tej për vlerësimin e mbarëvajtjen e tij. Për programin në fjalë, impakti i këtij procesi zhvlerësohet nga numri i studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>U konstatua se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit realizohet në mënyrë formale pasi numri i studentëve nuk është i mjaftueshëm për të gjeneruar analiza dhe të dhëna konkrete.</p> <p>Meqenëse programi nuk ka qenë aktiv për dy vite, edhe instrumentet e tjerë të vlerësimit (megjithëse ekzistojnë) nuk rezultojnë efikase.</p> <p>Me konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryhet vlerësimi i pedagogëve nga studentët (sipas RVB këto janë esenciale për evoluimin e programit të studimit); - Departamenti harton analiza në lidhje me notat dhe me të dhënat e pyetësorit të studentëve; - Hartohen raporte vjetore nga Bordi i Provimeve të cilat i përcillen Senatit Akademik dhe Komisionit të Cilësisë; - Hartohet Raporti vjetor institucional ku ka të dhëna mbi diplomimet, kalueshmërinë etj.
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës konstatoi se metodat e vlerësimit të përdorura janë të unifikuara në rang institucioni por nuk rezultojnë efektive për programin e studimit. U konstatua se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit realizohet në mënyrë formale pasi numri i studentëve nuk është i mjaftueshëm për të gjeneruar analiza dhe të dhëna konkrete.</p> <p>Referuar RVB për këtë kriter, metodat e listuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komentet e stafit akademik; - Komentet e studentëve; - Raportet e organeve akredituese.
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime</p>	<p>Institucioni ka ngritur një mekanizëm me instrumenta në të gjitha nivelet për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, i cili rezulton jo i efektshëm në rastin konkret, për shkak të situatës në të cilën ndodhet programi i studimit.</p> <p>Referuar RVB këtu mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizat që zhvillohen nga bordi i provimeve; - Ndjekja nga departamenti e problematikave të konstatuara nga pyetësi i studenteve. <p>[Aneksi 48, 50, 52, 54]</p>

lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>Institucioni ka ngritur një mekanizëm me instrumenta në të gjitha nivelet për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, i cili rezulton jo i efektshëm për shkak të situatës në të cilën ndodhet programi i studimit.</p> <p>Pyetësorët për cilësinë e mësimdhënies janë mjete kryesor i cili përfshin studentët, përmes anketimit elektronik (sistemi EIS) dhe përcjell informacionin për analiza të mëtejshme në strukturat drejtuese të universitetit [Aneksi 31.1].</p> <p><i>Referuar komenteve të marra përmes proceseve të akreditimit, institucioni ka përmbushur vetëm pjesërisht rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit në akreditimin e mëparshëm.</i></p> <p>Shih hyrjen e këtij raporti mbi përmbushjen e rekomandimeve.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe	IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen Komisioni për Sigurimin e Cilësisë, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke krijuar kushtet për përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.

përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi mundësojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë. [Aneksi 2, Aneksi 8].			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Meqenëse programi i studimit ka qenë jo aktiv për dy vite dhe numri aktual i studentëve është 1, parashikimet e kriterit 3 nuk mund të vlerësohen nga GVJ. Gjithsesi, në Statut dhe në rregulloret përkatëse u konstatua se parashikohet përfshirja e departamentit dhe fakultetit, personelit dhe studentëve në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. [Aneksi 2, 8, 9, 50]			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ, nga vizita në universitet dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoi se fryma institucionale dhe e dokumenteve bazë parashikojnë lirinë akademike, barazinë dhe garantojnë mungesën e diskriminimit në tërësi. [Aneksi 2, Aneksi 5]			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Meqenëse programi i studimit ka qenë jo aktiv për dy vite dhe numri aktual i studentëve është 1, parashikimet e kriterit 5 nuk mund të vlerësohen nga GVJ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	----------	--

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Informacioni mbi sistemin e sigurimit të cilësisë është publik dhe i afishuar në faqen ëeb të institucionit.</p> <p>https://aeqi.epoka.edu.al/</p> <p>Në këtë faqe ekziston informacion i detajuar mbi strukturat, politikat, dokumentet dhe raportet e hartuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë në universitetin Epoka.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në po të njëjtën faqe janë të aksesueshme informacioni mbi vlerësimet e brendshme dhe të jashtme si dhe mbi analizën e përmbushjes së rekomandimeve të evidentuara në proceset e akreditimit. Informacioni publik në ëeb paraqitet duke respektuar etikën akademike dhe duke mbrojtur të dhënat personale në përputhje me parashikimet ligjore.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Përmbushja e rekomandimeve të dala nga proceset e akreditimit pasqyrohet e në dokumente analitike të hartuara me qëllim evidentimin e masave të marra nga institucioni për çdo problematikë të evidentuar. Këto dokumente janë publike dhe të aksesueshme në https://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-for-ascal-1479-1480.html?lang=EN&dpid=2&t=internal-evaluation-reports-for-ascal&catid=1479&menuid=1480</p> <p>[Aneksi 30]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Meqenëse programi i studimit ka qenë jo aktiv për dy vite dhe numri aktual i studentëve është 1, parashikimet e kriterit 4 nuk mund të vlerësohen nga GVJ.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për</p>	<p>Megjithëse institucioni organizon veprimtari periodike përmes zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, impakti i këtyre</p>

informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	procese nuk mund të vlerësohet specifikisht për këtë program studimi (programi i studimit ka qenë jo aktiv për dy vite dhe numri aktual i studentëve është 1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Mësimdhënia në Universitetin Epoka zhvillohet në gjuhën angleze;
2. Infrastruktura dhe shërbimet në universitet ofrojnë një mjedis cilësor për aktivitetin akademik;
3. Përmbajtja e programit të studimit është hartuar në kuadrin e një projekti ndërkombëtar me kontribut dhe ekspertizë të universiteteve partnere;
4. Programi i studimit është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe ofron formim për specialistë në menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit, dy fusha mjaft të rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe sigurinë e popullatës;

b. Pika të dobëta:

1. Institucioni nuk ka plotësuar tërësisht rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit në akreditimin e mëparshëm;
2. Mos-funksionimi i programit për dy vite akademike (2019-2020 dhe 2020-2021) rrezikojnë vijimësinë e tij;
3. Orët në auditor të zhvilluara në vitin akademik 2021-2022 rezultojnë të jenë më të vogla se parashikimi i planit mësimor (rreth 280 orë/vit ose 8-10 orë/javë);
4. Personeli akademik është i mbingarkuar me mësimdhënie. Ngarkesa e tyre mësimore konsumohet kryesisht në programe të tjera studimi;

Rekomandime:

1. GVJ i rekomandon Institucionit të përmbushë rekomandimet 1, 3 dhe 6 të lëna nga akreditimi i mëparshëm;
2. Të përcaktohet numri minimal i studentëve për aktivizimin e programit të studimit. Ky numër duhet të jetë jo më i vogël se 5 studentë për të garantuar ndërveprimin minimal të nevojshëm në një program studimi të ciklit të dytë;
3. Të hartohet një plan veprimi për promovimin e programit të studimit dhe garantimin e vazhdimësisë të tij;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in "Risk Management and Fire Protection in Civil Engineering"

a. Strengths and Affirmations:

1. Teaching at Epoka University takes place in English;
2. The infrastructure and services at the university provide a quality environment for academic activity;
3. The content of the study programme was designed in the framework of an international project with the contribution and expertise of partner universities;
4. The study program is the only one of its kind in Albania and offers training for specialists in risk management and fire protection, two very important areas for the development of the country and the safety of the population;

b. Weak points:

1. The institution has not completely fulfilled the recommendations left by the Accreditation Board in the previous accreditation.
2. Non-functioning of the program for two academic years (2019-2020 and 2020-2021) endangers its continuity;
3. The class hours in the academic year 2021-2022 turn out to be less than the teaching load foreseen (about 280 hours/year or 8-10 hours/week);
4. The academic staff is overloaded with teaching. Their teaching load is mainly consumed in other study programmes;

Recommendations:

1. The evaluation group recommends the Institution to fulfill recommendations 1, 3 and 6 left by the previous accreditation;

2. To determine the minimum number of students for the activation of the study program. This number must be no less than 5 students to guarantee the minimum interaction necessary in a second cycle study program;
3. To draw up an action plan for promoting the study program and guaranteeing its continuity;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

